

FADIL LATIFI, ZEQR KADRIU

**PËRDORIMI I METODAVE BASHKËKOHORE TË MËSIMDHËNIES
SË GJUHËS SHQIPE NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME
TË ULËTA***

I. LITERATURA E SHQYRTUAR

Në teorinë dhe praktikën mësimore bashkëkohore, çështja e metodave mësimore zë një rëndësi të veçantë, meqë ato shoqërojnë tërë ecurinë e zhvillimit mësimor. Zylfiu (2005) ka theksuar se fjala metodë rrjedh nga gjuha greke (methodos), që do të thotë rrugë ose mënyrë me të cilën udhëhiqemi me rastin e realizimit të detyrave dhe veprimeve të punës. Në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (1981), fjala metodë nënkupton tërësinë e parimeve teorike themelore që shërbejnë si mbështetje e si udhëheqje për të njohur natyrën e jetën shoqërore dhe për t'i shndërruar ato. Tërësia e mënyrave dhe e mjeteve që përdoren për të studiuar e për të shpjeguar diçka. Metoda dialektike, metoda eksperimentale etj.

Metodat mësimore kanë një histori të gjatë, meqë nga zanafilla e punës edukative dhe arsimore, ato gjithnjë kanë shoqëruar procesin e zhvillimit të mësimin. Krahas zhvillimit të mësimin dhe bazës teorike e praktike të organizimit të kësaj veprimtarie, janë zhvilluar edhe metodat mësimore, si pjesë e pandarë e punës edukative dhe arsimore (Zylfiu, 2005, f. 307-357). Notturmo M. & Notturmo L. (n.d) theksuan se metodat e mësimdhënies janë prezantuar qysh në mitologjinë greke. Sot, shumë njerëz mendojnë se përdorimi i metodës së drejtë të mësimdhënies është kritik në procesin e të mësuarit dhe gjithashtu në zhvillimin e studentit të ri. Disa mendojnë se përdorimi i metodës së gabuar mund ta çojë studentin në një stad falimentimi, dhe ta shtyjë atë në një braktisje të shkollës.

Përdorimi i drejt i metodave mësimore në gjuhën shqipe ndikon edhe në formimin e personalitetit të nxënësve, duke i aftësuar dhe përgatitur ata për jetë dhe punë, sidomos për vetëarsimim dhe vetëmësim, si një ndër kërkesat më bashkëkohore që i shtrohet shkollës sonë. Siç thekson edhe Basariček (1922), lidhur me metodat mësimore ekzistojnë shumë përkufizime por të gjitha përfshijnë në vetvete kryesisht strukturat e shtjellimeve që bëjnë më sipër, sepse në to qëndron kuptimi i arsytimit të vlerës që kanë metodat mësimore, pa marrë parasysh se si trajtohen ato; si veprime, mjete, forma apo etapa. Metodat duhet të synojnë punën e përbashkët të arsimtarit dhe të nxënësve.

Nëse i bëjmë një vështrim retrospektiv zhvillimit të teorisë dhe praktikës mësimore, shohim se disa nga metodat që përdoren sot, janë përdorur edhe në të kaluarën edhe pse në kushte dhe rrethana të tjera. Shikuar nga aspekti didaktik, çështje e metodave mësimore ka qenë dhe mbetet pjesë përbërëse e veprimtarisë

* Të dhënat nga hulumtimi i doktoratës në komunën e Gjilanit, Kosovë.

teorike dhe praktike e çdo mësimdhënësi. Trajtimet e përhershme të metodave kanë lënë gjurmë duke u dhënë kah zhvillimeve të ndryshme të kësaj çështjeje me rëndësi në organizimin e punës mësimore. Në procesin e zhvillimit të metodave mësimore si në të kaluarën, ashtu edhe sot, ekzistojnë disa qëndrime ende të paharmonizuara, sidomos kur është fjala për çështjen e klasifikimit të tyre dhe përdorimit të një apo të më shumë metodave mësimore.

Zylfiu (2005) ka gjetur se edhe Sokrati, Platoni dhe Aristoteli në punën e tyre arsimore, përdornin metodat mësimore. Kështu edhe sot është i njohur varianti i metodave sokratike e bashkëbisedimit si dhe dialogu i Sokratit. Kuintiliani (n.d) theksoi se në vend të ndëshkimeve trupore, mësimdhënësit duhet të përdorin metoda të ndryshme mësimore. Ndërsa (Zylfiu, 2005) duke cituar Jan Amos Komenskin (1954) thekson se Komenski, Loku, Ruso e Pestaloci që të gjithë ishin përkrahës të monometodizmit (përdorimit të një metode) në mësim.

Shihet qartë se zhvillimi i metodave mësimore ka kaluar në disa etapa, ndërsa e rëndësishme ishte edhe koha e prezantimit të metodave aktive me theks të veçantë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në mësim. Këto ide dolën në pah nga pedagogë të njohur si M. Montesori, R. Dortrani etj. Këto lëvizje ndikuan që në teorinë dhe praktikën e punës mësimore ndikuan në popullarizimin dhe vënien në jetë të ideve të tyre me përdorimin aktiv të metodave mësimore të cilat u bënë pjesë përbërëse e punës së mësimdhënësit dhe nxënësit. Lidhur me nevojën për ndryshime si në sferën e arsimit, po ashtu edhe në sfera të tjera Fullan (2001, f. 15-20) thekson: “Çdo gjë duhet të ndryshojë një herë, sepse, përndryshe do të zhvillohet një shoqëri statike”. Kërkesa për përdorimin e metodave mësimore rrjedh nga thelbi i vet organizimit të punës mësimore dhe struktura didaktiko-metodike e artikullimit të procesit mësimor. Sipas Zylfiut (2005), polimetodizmi duhet kuptuar si kërkesë që rrjedh nga karakteri i diferencuar i organizimit të mësimit mbi bazat e modaliteteve të shumta didaktike, sipas së cilave pjesëmarrja e nxënësve është pikënisje në zgjedhjen dhe përcaktimin e metodave, krahas lëndës që duhet përvetësuar.

Autorë të ndryshëm kanë bërë edhe ndarje të ndryshme sa i përket metodave mësimore. P.sh. Zylfiu (2005) i cili ka cituar B. P. Jesipoviçin (1964), metodat mësimore i ndanë në këtë mënyrë: Shpjegimi i arsimtarit, biseda (në kushte natyrore dhe të veçanta), të vërejturit, ekskursioni, demonstrimi, metoda e leximit e shoqëruar me sqarime.

Ndërsa Çamo (1986), në mënyrë tejet analitike i shtron metodat mësimore, duke i radhitur edhe disa forma dhe veprime të etapave zhvillimore të punës mësimore:

1. Metoda e dhënies dhe të përpunimit të njohurive, të shkathtësive dhe të shprehive ku bëjnë pjesë: shpjegimi, kallëzimi, ligjërata shkollore, biseda, demonstrimi, metoda problematike etj.
2. Metodatat e përforsimit dhe të zbatimit të njohurive, të shkathtësive dhe të shprehive si: përsëritje, ushtrimet, puna me tekstin dhe literaturën plotësuese, puna praktike laboratorike dhe matjet në terren, punët me karakter zbatues.
3. Metodatat e të nxënësit dhe në metodatat e përvetësimit të

Gabimet drejtshkrimore në hartimet e nxënësve të shkollës fillore...

njohurive, të shkathtësive dhe të shprehive si: të nxënësve riprodhues, të nxënësve induktiv-deduktiv, të nxënësve analizues-sintetizues, të nxënësve krahasues etj.

Sipas Becit (2006), metodat e mësimdhënies mund të grupohen në tri grupe themelore:

1. Metodatat sintetike,
2. Analitike dhe
3. Globale

Shikuar nga aspekti i teorisë bashkëkohore didaktike, mund të themi se pikënisja në përcaktimin e kriterëve të duhura në zgjedhjen dhe zbatimin e metodave mësimore qëndron në njohjen e dimensioneve; psikologjike, logjike-gnosologjike, sociale etj., me qëllim të nxitjes së aktivitetit të nxënësve në procesin mësimor. Në këtë drejtim, metodat më të njohura janë:

1. Metoda verbalo-tekstuale;
2. Metoda ilustrativo-demonstruese;
3. Metoda laboratoriko-eksperimentale (Brada, 2005, f. 117).

Studiues bashkëkohorë, metodat e mësimdhënies i ndajnë në dy grupe kryesore:

1. Metodatat që kanë në qendër mësuesin.
2. Metodatat që kanë në qendër veprimtarinë e nxënësit (Zylfiu, 2011, f. 275).

II. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për të hulumtuar dhe studiuar këtë problem në mënyrë të gjithanshme do të përdorim disa metoda të hulumtimit. Ndër to më të rëndësishme janë:

Metodën e analizës teorike, metodën përshkruese, metodën statistikore. Anketimi është realizuar nëpërmjet pyetësorit të përpiluar për nxënësit. Të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorit janë të burimeve primare dhe një pasqyrë reale e gjendjes momentale të përdorimit të metodologjisë bashkëkohore në mësimdhënien e gjuhës shqipe. Këto të dhëna janë përpunuar përmes metodave të lartpërmendura dhe nga to do të nxirren konkluzionet e duhura dhe rekomandimet e nevojshme.

Pasi që popullacioni i këtij hulumtimi është i madh, sepse atë e përbëjnë të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në Kosovë, jemi të detyruar që hulumtimin ta bëjmë me një mostër. Mostra jonë është e qëllimshme, e zgjedhur rastësisht nga rajoni i Anamoravës, përkatësisht komunën e Gjilanit. Për mostër kemi caktuar 2 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta (nëntëvjeçare) nga kjo komunë, përkatësisht një shkollë në zonë urbane (komuna e Gjilanit, sh.f. Selami Hallaçi) dhe një shkollë në zonë rurale (fshati Livoç i Epërm, sh.f. Vatra e Diturisë). Procedurave të anketimit do t'i nënshtrohen nxënësit e 2 klasave të pesta dhe nxënësit e 2 klasave të nënta që janë gjithsej 115 nxënësit.

III. HIPOTEZA E PËRGJITHSHME

Për studimin e mirëfilltë të këtij problemi, kemi paraparë hipotezën kryesore dhe ato ndihmëse. Si hipoteza kryesore po ashtu edhe ato ndihmëse do të elaborohen dhe studiohen në mënyrë të detajuar në aspektin teorik dhe praktik përmes hulumtimit me qëllim të vërtetimit ose jo të këtyre hipotezave.

a) **Hipoteza kryesore;** Supozojmë se mësimdhënësit (klasor dhe lëndor) e gjuhës shqipe nuk i praktikojnë në masë të duhur metodat bashkëkohore të cilat nxisin veprimtarinë e nxënësit.¹

b) **Hipoteza ndihmëse;** Supozojmë se ngecje më të mëdha në përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës shqipe, ka në zonat rurale në krahasim me ato urbane.

IV. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME NGA ANKETIMI I NXËNËSVE NË KOMUNËN E KAMENICËS DHE REZULTATET E ANKETIMIT

Në hulumtim janë të përfshirë gjithsej 115 nxënës nga klasat e V-ta dhe të IX-ta të komunës së Gjilanit, përkatësisht 55 nxënës nga shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Selami Hallaçi” në Gjilan dhe 60 nxënës nga shkolla fillore dhe e mesme e ulët “Vatra e Diturisë” nga fshati Livoç i Epërm i komunës së Gjilanit. Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur të dhënat e nxënësve sipas klasave, sipas gjinisë dhe vendit.

Klasa				
Klasa V-të dhe IX-të S.H. Klasa V-të dhe IX-të V.D.				
Gjinia		M	F	
		26 47,27 %	29 52,72%	
Gjithsej		55 nxënës ose 47,82%		60 nxënës ose 52,17%
Komuna, shkolla dhe vendi		Gjilan		
		Sh.f.m.u. “ Selami Hallaçi” dhe		
		Livoç i Epërm		
		Sh.f.m.u. “ Vatra e Diturisë”		
		Komuna <u>Gjilan</u>		

Të dhënat e përgjithshme të nxënësve të klasave të V-ta dhe të IX-ta rreth gjinisë, vendit dhe shkollës në komunën e Gjilanit (Shih në fund të artikullit)

Rezultatet e anketimit të nxënësve në komunën e Gjilanit

Përveç paraqitjes së të dhënave sipas shkollave dhe krahasimit të këtyre të dhënave sipas klasave, e kemi parë të arsyeshme që në kuadër të punimit t'i paraqesim dhe t'i krahasojmë edhe të dhënat e dala nga anketimi i nxënësve sipas shkollave dhe njëkohësisht këto të dhëna edhe t'i krahasojmë ndërmjet vete. Të dhënat e grumbulluara nga pyetësi i zhvilluar me nxënës sh.f.m.u. “Selami Hallaçi” në Gjilan dhe “Vatra e Diturisë” nga fshati Livoç i Epërm komuna e Gjilanit, tregojnë për dallime të mëdha në përdorimin të metodologjive të reja nga mësimdhënësit që punojnë në qytet në krahasim me kolegët e tyre që punojnë në fshat.


¹ Me veprimtari të nxënësit kuptojmë kur tek nxënësit arrijmë të zhvillojmë fjalorin, të nxënës bashkëpunues, nxitjen e diskutimit, të lexuarit ndërveprues, nxitjen për të përsosur të shkruarit, paraqitjen grafike të informacioneve, ndërtimin e shprehive studimore, etj.

Gabimet drejtshkrimore në hartimet e nxënësve të shkollës fillore...

Në deklaratën e parë, *mësuesi (arsimtari) im përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës shqipe* të cilën e kemi paraqitur në pyetësin për nxënësit e sh.f.m.u. “Selami Hallaçi” dhe sh.f.m.u. “Vatra e Diturisë”, kemi vërejtur dallime të mëdha në mendimet dhe qëndrimet e nxënësve nga të cilët ndjekin mësimet në zonat urbane (*tutje ZU*) në krahasim me nxënësit e të cilët ndjekin mësimet në zonat rurale (*tutje ZR*). Nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 31 apo 56.36% prej tyre, janë deklaruar për alternativën *çdoherë*, ndërsa kjo përqindje është dukshëm më e vogël tek nxënësit që mësojnë në ZR, përkatësisht nga 60 nxënës të anketuar, vetëm 9 apo 15% prej tyre janë përcaktuar për alternativën *çdoherë*. Mesatarja e nxënësve nga komuna e Gjilanit, të deklaruar se *çdoherë* mësimdhënësit përdorin *shumëllojshmëri të metodave për të nxitur idetë tona*, është 40 nxënës apo 34,78%. Për alternativën *herë-herë* janë deklaruar 15 nxënës nga ZU apo 27.27% dhe 9 nxënës nga ZR apo 16% prej tyre. Mesatarja komunale është 24 nxënës apo 20.68%. Ndërsa për alternativën *rrallë* janë deklaruar 8 nxënës nga ZU apo 14.54% dhe 38 nxënës nga ZR apo 63.33% me një mesatare komunale prej 46 nxënësish apo 40%. 1 nxënës nga ZU apo 1.81% dhe 4 nxënës nga ZR apo 6.66% janë deklaruar për alternativën *asnjëherë*.

Përmes pyetësit gjithashtu kemi dashur të dimë nëse mësimdhënësit përdorin një *shumëllojshmëri të metodave bashkëkohore për të nxitur idetë e nxënësve* dhe në këtë drejtim ekziston një dallim shumë i madh në mes të mendimeve dhe qëndrimeve të nxënësve nga ZU dhe nxënësve nga ZR. Nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 38 apo 69.09% janë deklaruar për alternativën *çdoherë*, ndërsa nga 60 nxënës të anketuar nga ZR, për të njëjtën alternativë janë deklaruar 19 nxënës apo 31.66%. Mesatarja komunale sa i përket alternativës *çdoherë* është 57 nxënës apo 49.56%. Për alternativën *herë-herë* janë deklaruar 7 nxënës nga ZU apo 12.72% dhe 28 nxënës nga ZR apo 46.66%.

Deklarata e katërt ka pasur për qëllim që të vërej nëse nxënësit janë *aktivë në ndërtimin e dijeve të tyre apo jo*. Rezultatet e grumbulluara nga kjo deklaratë kanë dëshmuar se nxënësit nga ZU janë më aktivë në ndërtimin e dijeve të tyre në krahasim me nxënësit nga ZR. Nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 43 apo 78.18% prej tyre janë deklaruar se janë *çdoherë* aktivë dhe pjesëmarrës në ndërtimin e dijeve të tyre, ndërsa për këtë fakt nga 60 nxënës nga ZR, janë deklaruar 25 apo 41.66% prej tyre.



Krahasimi i mendimeve të nxënësve për katër deklaratat e para sipas kriterit zonal

Pjesa tjetër e deklarimeve të nxënësve përqendrohet tek alternativat *herë-herë* dhe *rrallë*, ndërsa 1 nxënës nga ZU apo 1.81% dhe 7 nxënës nga ZR apo 11.66% janë deklaruar për alternativën *asnjëherë*. Për të parë edhe më për së afërmi rezultatet e katër deklaratave, po i paraqesim përmes grafikut. Nga rezultatet e 4 deklaratave të para vërehet se shumica e mendimeve të nxënësve përkrahin idenë se mësuesit nga ZU përdorin më tepër metodologji të reja të mësimdhënies, në krahasim me mësimdhënësit nga ZR, gjë e cila sjell edhe rezultate më të mira në mësimdhënien e tyre. Për të parë nëse mësimdhënësit e shfrytëzojnë teknologjinë në mësimdhënien e tyre dhe përparësitë që mundëson kjo teknologji, në pyetësorin e përgatitur për nxënës ne kemi paraqitur një deklaratë rreth *përdorimit të kompjuterit dhe projektorit në mësimdhënie* dhe kemi vërejtur se përqindja e mësimdhënësve që përdorin kompjuterin është mjaft e vogël. Nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 20 apo 36.36% prej tyre janë deklaruar se mësimdhënësit e përdorin *çdoherë* teknologjinë në mësimdhënie, ndërsa nga 60 nxënës të anketuar që ndjekin mësimet në ZR vetëm 3 apo 4.80% deklarohen për këtë fakt. Për alternativën *asnjëherë* janë deklaruar 17 nxënës nga ZU apo 30.90% dhe 23 nxënës nga ZR apo 38.33%. Këto të dhëna dëshmojnë se mësimdhënësit në masë të madhe nuk e përdorin kompjuterin dhe projektorin në mësimdhënien e tyre.

Mendime të përafërta të nxënësve të ZU dhe ZR janë paraqitur kur i kemi pyetur nxënësit *nëse përdorimi i metodologjisë bashkëkohore nënkupton edhe më shumë zhurmë në klasë*, me që rast kemi vërejtur se mendimet e nxënësve janë të përqendruara rreth alternativës *herë-herë* dhe *rrallë*. Pra, nga 55 nxënës të anketuar që ndjekin mësimet në ZU, 18 nxënës apo 32.72% prej tyre janë deklaruar për alternativën *herë-herë*, ndërsa nga 60 nxënës të anketuar nga ZR, 28 apo 46.66% janë deklaruar për të njëjtën alternativë. Për alternativën *rrallë* janë deklaruar dhe 27 nxënës nga ZU apo 49.09% dhe 14 nxënës nga ZR apo 23.33%. Se *asnjëherë* metodat bashkëkohore të mësimdhënies nuk janë shkaktare të zhurmës në klasë janë deklaruar 6 nxënës nga ZU apo 10.90% dhe 10 nxënës nga ZR apo 16.66%.

Vendosja e punimeve të nxënësve në pjesët e dukshme është një element mjaft i rëndësishëm për të nxënësit e nxënësit. Nga gjithsej 55 nxënës të anketuar nga ZU, 29 apo 52.72% prej tyre janë deklaruar se *punimet e bëra nga nxënësit i vendosim në pjesët e dukshme të klasës*, ndërsa nga 60 nxënës të anketuar nga ZR, 46 apo 76.66% prej tyre janë deklaruar për këtë fakt. Për alternativën *herë-herë*, janë deklaruar 19 nxënës nga ZU apo 34.54% dhe 8 nxënës apo 13.33% e nxënësve nga ZR. Se *asnjëherë* nuk vendosen punimet e nxënësve në pjesët e dukshme të klasës, janë deklaruar 3 nxënës nga ZU apo 5.45% dhe 2 nxënës nga ZR apo 3.33%.

Gabimet drejtshkrimore në hartimet e nxënësve të shkollës fillore...

Për të ditur nëse puna në dyshe dhe në grupe gjen zbatim njësoj si në ZU po ashtu edhe në ZR, në kuadër të pyetësorit ne kemi paraqitur një deklaratë e cila kërkon mendimin e nxënësve *nëse nxënësit aktivitetet e tyre i zhvillojnë në dyshe apo në grupe*. Pas grumbullimit të të dhënave kemi vërejtur se nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 32 apo 58.18% janë deklaruar se *çdoherë* praktikohet puna në grupe dhe në dyshe, ndërsa nga 60 nxënës të anketuar nga ZR, kjo përqindje është më e lartë, përkatësisht nga 60 nxënës të anketuar 40 apo 66.66% janë deklaruar për punën në dyshe dhe në grupe.

Interneti është një nga burimet ku nxënësit mund të pajisen me dije të reja dhe njëkohësisht mund të thellojnë njohuritë e tyre për fusha të caktuara. Ne kemi dashur që përmes një deklarate të paraqitur në pyetësor, të marrim mendimet e nxënësve lidhur me përdorimin e burimeve të tjera të informatave përveç librit. Rezultatet tregojnë se edhe në këtë fushë, nxënësit nga ZU janë më hulumtues në krahasim me nga ZR. Nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 33 apo 60% prej tyre janë deklaruar se *çdoherë e përdorin internetin si burim të informatave*, ndërsa nga 60 nxënës të anketuar nga ZR vetëm 13 nxënës apo 21.66% prej tyre deklarohen për këtë fakt. Faktet tregojnë se 5 nxënës nga ZU apo 9.09% dhe 5 nxënës nga ZR apo 8.33% prej tyre janë deklaruar se *asnjëherë* nuk e shfrytëzojnë internetin për çështje mësimore.

Njëra nga deklaratat e paraqitura në pyetësor ka pasur për qëllim që të marrë opinionin e nxënësve *nëse mendimet e tyre merren në konsideratë nga ana e mësimit në klasë*. Në këtë rast nuk kemi vërejtur dallime të mëdha në mendimet e nxënësve nga ZU me ata të ZR, përkatësisht nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 31 apo 56.36% janë deklaruar se *mendimet e tyre çdoherë merren në konsideratë nga mësimit në klasë*, ndërsa nga 60 nxënës të anketuar nga ZR, 35 apo 58.33% prej tyre janë deklaruar për këtë fakt. Shumica me mendimeve të nxënësve janë të përqendruara rreth alternativave *herë-herë* dhe *rrallë*.

Deklarata e radhës ka për qëllim të kuptojë nëse nxënësit *e ndiejnë vetën të lirë të pyesin dhe nga kush pastaj i marrin përgjigjet, nga mësimit në klasë apo nga diskutimet në klasë*. Edhe në këtë rast kemi vërejtur se liria e të pyeturit dhe e diskutimit të përgjigjeve në klasë, gjen zbatim më të madh tek nxënësit nga ZU në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre që ndjekin mësimet e tyre në ZR. Nga gjithsej 55 nxënës të anketuar të klasës nga ZU, 39 apo 70.90% prej tyre janë deklaruar se *çdoherë janë të lirë të pyesin dhe përgjigjet i marrin nga diskutimet në klasë*, ndërsa numri i nxënësve nga ZR që është përcaktuar për alternativën *çdoherë* është më i vogël, përkatësisht nga 60 nxënës të anketuar, 37 apo 61.66 % janë pro këtij fakti. Se nxënësit nuk janë të lirë *asnjëherë* të pyesin dhe të diskutojnë çështje të rëndësishme në klasë janë deklaruar 2 nxënës nga ZU apo 3.63% dhe 7 nxënës nga ZR apo 11.66% prej tyre.

Në deklaratën e parafundit i kemi pyetur nxënësit nëse brenda vitit shkollor *zhvillojnë ndonjë njësi mësimore në natyrë*, nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 48 apo 87.27% prej tyre janë deklaruar për alternativën *çdoherë*, ndërsa nga 60 nxënës të anketuar nga ZR, për këtë fakt janë deklaruar vetëm 4 nxënës apo 6.66%. Është numri mjaft i madh i nxënësve nga ZR që janë deklaruar se

asnjëherë nuk dalin në natyrë për të mbajtur ndonjë orë mësimore. Për alternativën *asnjëherë* janë deklaruar 33 nxënës nga ZR, apo 55% ndërsa për të njëjtën alternativë nuk është deklaruar asnjë nxënës nga ZU.

Për të parë nëse mësimdhënësit reflektojnë ndaj asaj që është punuar brenda orës mësimore, në pyetësonin e përgatitur kemi dhënë një deklaratë e cila ka për qëllim të marrë mendimet e nxënësve *nëse mësimdhënësit e tyre e shfrytëzojnë pjesën e fundit të orës për të reflektuar rreth asaj që është mësuar apo jo*. Nga 55 nxënës të anketuar nga ZU, 34 apo 61.81% janë deklaruar se *çdoherë mësimdhënësit reflektojnë në fund të orës mësimore*, ndërsa përqindja është më e ulët tek nxënësit që ndjekin mësimet në ZR, përkatësisht nga 60 nxënës të anketuar, 29 nxënës apo 48.33% prej tyre janë deklaruar për alternativën *çdoherë*. Është pozitive se numri i nxënësve të klasave të V-ta dhe të deklaruar për alternativën *asnjëherë* është mjaft i vogël, përkatësisht për këtë alternativë janë deklaruar 3 nxënës nga ZU apo 5.45% dhe 4 nxënës nga ZR apo 6.66%.

Nga rezultatet e grumbulluara përmes anketimit të nxënësve nga ZU, përkatësisht nga sh.f.m.u. “Selami Hallaçi” dhe nga ZR përkatësisht nga sh.f.m.u. “Vatra e Diturisë”, mund të përfundojmë se ekzistojnë një përparësi dhe në përgjithësi një përqindje më e lartë e përdorimit të metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës shqipe nga mësimdhënësit që punojnë në ZU në krahasim me kolegët e tyre që punojnë në ZR. Në shumicën e deklaratave të cilat janë paraqitur në pyetësor, epërsi më të lartë të përqindjes kanë pasur nxënësit të cilët ndjekin mësimet në zonat urbane (ZU) në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga zonat rurale (ZR). Shikuar në tërësi, rezultatet e përgjithshme të përdorimit të metodologjive të reja të mësimdhënies së gjuhës shqipe, në komunën e Gjilanit nuk janë edhe aq të kënaqshme dhe ka vend për përmirësime.

Gabimet drejtshkrimore në hartimet e nxënësve të shkollës fillore...

Pyetësor për nxënës	Çdoherë		Herë herë		Rrallë		Asnjëherë		Nuk e di	
	Selami Hallaçi	Vatra e Diturisë	Selami Hallaçi	Vatra e Diturisë	Selami Hallaçi	Vatra e Diturisë	Selami Hallaçi	Vatra e Diturisë	S.H.	V.D.
1. Mësuesi (arsimtari) im përdor metoda bashkëkohore të mësimit në gjuhën shqipe.	31 56,36 %	9 15%	15 27,27%	9 15%	8 14,54%	38 63,33%	1 1,81%	4 6,66%	0 0%	0 0%
	40 ose 34,78%		24 ose 20,86%		46 ose 40%		5 ose 4,34%		0 ose 0%	
2. Mësimdhënësit përdorin shumë llojshmëri të metodave apo teknikave mësimore për të ndihmuar nxënësit të mësojnë.	38 69,09 %	19 31,66%	7 12,72%	28 46,66%	6 10,90%	11 18,33%	4 7,27%	2 3,33%	0 0%	0 0%
	57 ose 49,56%		35 ose 30,43%		17 ose 14,78%		6 ose 5,21%		0 ose 0%	
3. Mësimdhënësit kujdesen që djetet tona të mësojnë në një bazë për ndërtimin e njohurive të reja.	38 69,09 %	19 31,66%	14 25,45%	10 16,66%	1 1,81%	29 48,33%	2 3,63%	2 3,33%	0 0%	0 0%
	57 ose 49,56%		24 ose 20,86%		30 ose 26,08%		4 ose 3,47%		0 ose 0%	
4. Ne jemi pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e njohurive tona.	43 78,18 %	25 41,66%	9 16,36%	19 31,66%	2 3,63%	9 16%	1 1,81%	7 11,66%	0 0%	0 0%
5. Mësimdhënësit përdorin edhe teknologjinë digjitale (kompiutrin, projektorin etj).	68 ose 59,13%	20 36,36 %	28 ose 24,34%	17 30,90%	11 ose 9,56%	1 23 38,33%	8 ose 6,95%	17 23 38,33%	0 0%	0 0%
	23 ose 20%		28 ose 24,34%		24 ose 20,86%		40 ose 34,78%		0 ose 0%	
6. Përdorimi i metodave bashkëkohore nënkupton edhe më shumë zhurmë në klasë.	2 3,63%	6 10%	18 32,72%	28 46,66%	27 49,09%	14 23,33%	6 10,90%	10 16,66%	2 3,63%	2 3,33%
	8 ose 6,95%		46 ose 40%		41 ose 35,65%		16 ose 13,91%		4 ose 3,47%	
7. Punimet tona i vendosim në pjesët e dukshme të klasës.	29 52,72 %	46 76,66%	19 34,54%	8 13,33%	4 7,27%	4 6,66%	3 5,45%	2 3,33%	0 0%	0 0%
	75 ose 65,21%		27 ose 23,47%		8 ose 6,95%		5 ose 4,34%		0 ose 0%	
8. Aktivitetet e ndryshme në klasë i zhvillojmë në dyse në grupe.	32 58,18 %	40 66,66%	12 21,81%	12 20%	7 12,72%	7 11,66%	4 7,27%	1 1,66%	0 0%	0 0%
9. Përveç librit, si burim tjetër të informacionit shfrytëzoj edhe internetin.	72 ose 62,60%	33 60%	24 ose 20,86%	9 16,36%	14 ose 12,17%	8 16,66%	5 ose 4,34%	5 8,33%	0 ose 0%	0 ose 0%
	46 ose 40%		35 ose 30,43%		24 ose 20,86%		10 ose 8,69%		0 ose 0%	
10. Mendimi i secilit nxënës të klasës ka rëndësi dhe merret në konsideratë nga mësimitdhënësit.	31 56,36 %	35 58,33%	19 34,54%	12 20%	5 9,09%	11 18,33%	0 0%	2 3,33%	0 0%	0 0%
	66 ose 57,39%		31 ose 26,95%		16 ose 13,91%		2 ose 1,73%		0 ose 0%	
11. Ne jemi të lirë të parashtrijmë pyetje të ndryshme, ndërsa përgjigjet i marrim si rezultat i diskutimit në klasë.	39 70,90 %	37 61,66%	8 14,54%	7 11,66%	6 10,90%	9 16%	2 3,63%	7 11,66%	0 0%	0 0%
	76 ose 66,08%		15 ose 13,04%		15 ose 13,04%		9 ose 7,82%		0 ose 0%	
12. Brenda vitit shkollor, disa njësi mësimore nga lënda e gjuhës shqipe i zhvillojmë jashtë klasës.	48 87,27 %	4 6,66%	2 3,63%	10 16,66%	5 9,09%	13 21,66%	0 0%	33 55%	0 0%	0 0%
	52 ose 45,21%		12 ose 10,43%		18 ose 15,65%		33 ose 28,69%		0 ose 0%	
13. Në fund të orës, ne reflektojmë (përsërisim) rreth asaj që kemi mësuar.	34 61,81 %	29 48,33%	15 27,27%	15 25%	3 5,45%	12 20%	3 5,45%	4 6,66%	0 0%	0 0%
	63 ose 54,78%		30 ose 26,08%		15 ose 13,04%		7 ose 6,08%		0 ose 0%	

BIBLIOGRAFI

- A. Kostallari, J. Thomaj, Xh. Lloshi, M. Samara, J. Kola, P. Daka, A. Hidi (1981). *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe A-M*. Prishtinë: Rilindja.
- B. Beci (2006). *Valle shkronjash dhe tingujsh*. Podgoricë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore.
- B. Çamo (1986). *Didaktika*. Tiranë (n.p.).
- M. Fullan (2001). *Kuptimi i Ri i Ndryshimit në Arsim*. Tiranë: Edualba.
- M. Notturmo, & L. Notturmo (n.d.). *Metodat e mësimitdhënies*. Retrieved from http://www.jfdp.org/forum/forum_docs/1013jfdp54_1_040111090719.pdf
- N. Zylfiu (2005). *Didaktika (Teoria e mësimit dhe e mësimitdhënies)*. Prishtinë: Timegate.
- N. Zylfiu (2011). *Teoria e mësimit dhe proceset didaktike të mësimitdhënies*. Prishtinë: Printing press.
- R. Brada (2005). *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore*. Pejë: Dukagjini.
- S. Basariček (1922). *Pedagogjia*. Zagreb

